



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr.481 /19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi- Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “NNP CTA”sh.p.k - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: NTP “Ardhmeria” – z. Dashnim Jashari” B.I -Shtime, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shkollës fillore në Gjyrkoc” me nr. të prokurimit: 617-19-4374-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Komuna Shtime, më datën: 29.08.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “NNP CTA”sh.p.k - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shkollës fillore në Gjyrkoc” me nr. të prokurimit: 617-19-4374-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Komuna Shtime .

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës me titull: “Ndërtimi i shkollës fillore në Gjyrkoc” me nr. të prokurimit: 617-19-4374-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/ – Komuna Shtime, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “NNP CTA”sh.p.k - Prishtinë, aprovohet si e bazua, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 20.06.2019.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 15.07.2019.

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 15.07.2019.

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 25.07.2019.

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të pa suksesshëm është bërë me dt: 25.07.2019.

Data e vendimit të AK-së për dhënie të kontratës është bërë me dt: 25.07.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 30.07.2019.

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 02.08.2019.

Operatori ekonomik ankues “NNP CTA”sh.p.k - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 05.08.2019 me nr. 481/ 19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shkollës fillore në Gjyrkoc” me nr. të prokurimit: 617-19-4374-5-2-1,initiuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Komuna Shtime, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 59, 60, 61, 69, dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës .

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 09.08.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit në raportin e dt: 20.08.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim :

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Pretendimi i parë i OE ankues është se Grupi OE Osmani Holding Sh.p.k dhe Ferizi Lista e çmimeve nuk është plotësuar Refuzo tenderin pa kërkuar informata shtesë kusht administrative sipas nenit 39 të UOPP-së:

Ekspertja shqyrtuese duke u bazuar ne dokumentacionin në lëndë konstaton se Grupi i OE Osmani Holding Sh.p.k dhe Ferizi; nuk ka plotësuar listën e çmimeve për njësi për pozicionet 3,4,5,6,7 dhe 8. Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne nenin 39.8 tek shembujt të cilët nuk janë të vetmit ne RRUOPP-së ku thotë:

Lista e çmimeve nuk është plotësuar Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm
Prandaj nga sqarimet që u dhanë me lart del se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE NNP Kadolli Sh.p.k Lista e çmimeve nuk është plotësuar Refuzo tenderin pa kërkuar informata shtesë kusht administrative sipas nenit 39 të RRUOPP-së:

Ekspertja shqyrtuese duke u bazuar ne dokumentacionin në lëndë konstaton se OE NNP Kadolli Sh.p.k. Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne dokumentacionin ne ofertën e OE NNP Kadolli Sh.p.k konstaton se OE në fjalë nuk ka plotësuar listën e çmimeve tek dy pozicione, tek pozicioni 9.8 dhe 9.9, prandaj duke u bazuar ne RRUOPP-në 39.8 tek shembujt të cilët nuk janë të vetmit në RRUOPP-së ku thotë:

Lista e çmimeve nuk është plotësuar Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm
Prandaj nga sqarimet që u dhanë me lart del se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Pretendimi tjetër i OE ankues është se Edona Sh.p.k Gabimi aritmetike tejkalon shumë prej 2 % sipas nenit 41.8 pika ii te RRUOPP-së OE eliminohet.

Ekspertja shqyrtuese duke u bazuar ne dokumentacionin në lëndë dhe ne RRUOPP-n neni 41.8. pika ii, Ne rast se shuma e korrigjuar është me shume se +/- 2%, AK do te eliminoj OE dhe do te informoj me shkrim OE ne fjale duke përdorur formën standarde B42

Eksperti shqyrtues sqaron se në ofertën e OE Edona Sh.p.k gabimet aritmetikore e tejkalojnë 2% qe është e lejuar me LPP-në. Prandaj duke u bazuar ne sqarimet me larë del se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE i propozuar për kontratë “ Dashnim Jasharin B.I” nuk ka dorëzuar deklaratat vjetore të dorëzuara në administratën tatimore të Kosovës për 3 vitet e shkuara po ashtu nuk ka dorëzuar pasqyrat financiare por ka dorëzuar vetëm konfirmim të bankës d.m.th Kërkesën në pikën 8.1 dhe 8.2 të FDT-së nuk e plotëson kushtin e AK .

Eksperti shqyrtues sqaron se kërkesat e AK-së ne DT ka qenë:

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kërkesa. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjatë tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qenë prej jo më pak se 250,000.00 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia. Pasqyrat e qarkullimit financiar të kompanisë, të shoqëruar me qarkullim financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.

Gjithashtu eksperti shqyrtues duke u bazuar ne dokumentacionin në ofertën e OE-së të rekomanduar për kontratë, konstaton se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka bashkangjitur ne ofertën e tij Pasqyrat e qarkullimit financiar të kompanisë, apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës, por ka të bashkangjitur vetëm konfirmim prej bankës për qarkullim për periudhën 2016,1018. Prandaj duke u bazuar ne sqarimet me lart del se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 5

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE i rekomanduar për kontratë “ DASHNIM JASHARIN B.I”nuk ka dorëzuar asnjë kontratë e cila për se afërmi është e njëjtë me llojin e aktivitetit të prokurimit që është shkolle d.m.th kërkesën në pikën 9.1 dhe 9.2 të FDT-së nuk e plotëson kushtin e AK që OE duhet të dorëzojnë:

Lista e projekteve të ngjashme, vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo procesverbal të pranimit përfundimtar të punëve (kopje).

Ekspertja shqyrtuese duke u bazuar ne dokumentacionin në lëndë konstaton se OE i rekomanduar për kontratë ka të bashkangjitur listën e projekteve të përfunduara, mirëpo projektet e përfunduara kanë të bëjë me ndërtimin e ulët si:kanalizim, trotuare, rregullimi i terreneve sportive, pastrimi i akullit dhe borës, etj. gjë që nuk mund të llogaritet si punë e ngjashme, pasi që ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me ndërtim të lartë. Prandaj nga kjo qe u tha me lartë del se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Operatori ekonomik "NNP CTA" sh.p.k - Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 20.08.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 29.08.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE-së ankues, përfaqësuesja e AK-së, si dhe ekspertja profesionale e prokurimit ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Morina deklaroj: Pajtohem me mendimin e ekspertës shqyrtuese e cila në mënyrë profesionale i ka shqyrtuar të gjitha pikat ankimore dhe ka dhënë mendim që lënda të kthehet në rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Rexhaj e cila deklaroj: Ne jemi pajtuar me mendimin e ekspertës shqyrtuese.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertja profesionale e prokurimit znj. Beka deklaroj: Qëndroj prapa raportit të dhënë ekspertizës.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Morina deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të aprovoj ankesën tone si të bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Rexhaj deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 29.08.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE-së ankues, përfaqësuesja e AK-së, si dhe ekspertja profesionale e prokurimit të gjitha palët para panelit shqyrtues u pajtuan me raportin e ekspertit shqyrtues profesional të prokurimit.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë si dhe konform sqarimeve të ekspertit shqyrtues profesional të prokurimit.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Shtime.

1x1 OE-“ N.N.P.”CTA-Prishtinë.

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.